

LIGJ
Nr.9839, datë 10.12.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GRANTIT USHTARAK NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e grantit ushtarak ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5561, datë 27.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE USHTARAKE GRANT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë,
duke riafirmuar dhe njëherë marrëdhëniet e tyre të gjata miqësore;
duke iu referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e trajnimit ushtarak, teknikës dhe shkencës, datë 29.7.1992 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajnimit ushtarak të datës 19.11.1992;
me qëllim forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i dhurojë 1 062 500 (një milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Granti do të jetë i disponueshëm nga viti 2007.

Neni 2

Granti prej 1 062 500 (një milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lirash turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet si materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Granti prej 1 062 500 (një milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lirash turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohet në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik, i cili do të nënshkruhet ndërmjet zyrtarëve të të dyja palëve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos transferojë titujt, materialet/shërbimet një vendi ose pale tjetër, pa marrë më parë miratimin e Republikës së Turqisë, e cila ka dhënë këtë grant.

Neni 5

Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga palët lidhur me përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme për ratifikim, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjitha materialet dhe shërbimet e specifikuara në protokollin zbatues të jenë nxjerrë jashtë përdorimit nga inventari i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Republikës së Turqisë.

Çdo mosmarrëveshje e lindur gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me diskutime dhe bisedime dypalëshe.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhët shqip, turqisht dhe anglisht. Në rast të mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht i Marrëveshjes do të jetë prioritar.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar më 9.10.2007, në Ankara të Turqisë.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Neritan Kolgjini i ngarkuar me punë në A.I në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Ankara	Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë Alpaslan Erdogan Gjeneral Brigade Zv/drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Forcës dhe Menaxhim, Burimeve për Menaxhimin e Burimeve
---	---